

Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove



Nr./Br. 413/01-6689
Data/Datum 17.03.2022

Gjakovë-Djakovica-Gjakova

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO
FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË
KOSOVSKI FOND ZA ENERGETSKU EFIKASNOST
KOSOVO ENERGY EFFICIENCY FUND
ARKIVI - ARHIVA - ARCHIVE

Nr.Br.No. 14122
Nr. i fq./Br.Str./No.pg. 65
Data/Datum/Date: 25.02.22
PRISHTINË - PRISTINA - PRIŠTINA



Marrëveshja për Shërbime të Energjisë

ndërmjet

Fondi i Kosovës për Eficiencën e Energjisë

dhe

Komuna e Gjakovës

për

**Zbatimin e Masave të Eficiencës së Energjisë në Pallati i kulturës "Asim
Vokshi", rr. Nëna Tereza,**

Data:

25.02.2022

MARRËVESHJA PËR SHËRBIME TË ENERGJISË

Në bazë të Nenit 37 të Ligjit 06/L-079 për Eficiencë të Energjisë, MARRËVESHJA PËR SHËRBIME TË ENERGJISË është instrumenti kryesor i Fondit për Eficiencë të Energjisë-FKEE për zbatimin e investimeve të eficiencës së energjisë në subjektet publike në kuadër të komponentit qarkullues. Kjo MARRËVESHJE PËR SHËRBIME TË ENERGJISË (në tekstin e mëtejshëm: "MSHe") është bërë më (Data / Muaji / Viti) ndërmjet Fondit të Kosovës për Eficiencën e Energjisë (këtu e tutje "FKEE") e përfaqësuar nga Drejtori Menaxhues i tij, Z. Admir Shala duke vepruar bazuar në organogramin e FKEE-së dhe Komuna e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës, Z. Ardian Gjini këtu e tutje Komuna" (së bashku të referuara si "palë")

Ndërsa,

- a) FKEE është duke zbatuar Projektin e Kosovës për Eficiencën e Energjisë dhe Energjinë e Ripërtëritshme (këtu e tutje "Projekti") nën Marrëveshjen e Financimit ndërmjet SHOQATËS NDËRKOMBËTARE TË ZHVILLIMIT ("IDA" ose "Banka Botërore") dhe Republikës së Kosovës për IDA Credit 5508- XK, dhe Marrëveshja e Grantit ndërmjet IDA, duke vepruar si administrator i Komisionit Evropian - Programi i Partneritetit të Bankës Botërore Pjesa III për Fondin e Mirëbesimit Programor Single-Donator të Evropës dhe Azisë Qendrore përmes Fondit të Kosovës për Eficiencën e Energjisë për Grantin Nr. TF0B1487;
- b) Komuna që ka aplikuar për të marrë pjesë në Projekt i plotëson kriteret e Projektit;
- c) Komuna pranon rezultatet e tenderit të kryer për punimet e ndërtimit për masat e eficiencës së energjisë (MEE), si dhe bazën themelore të vendosur në raportin e kontrollit të energjisë dhe Masat e Eficiencës së Energjisë (MEE) që do të zbatohen në objektin e Komunës dhe nivelin e parashikuar të kursimeve vjetore të energjisë;

Prandaj, palët nënshkruan këtë MSHe për zbatimin e një nënprojekti komunal të eficiencës së energjisë në objektin e Komunës (këtu e tutje "nënprojekt") si më poshtë:

NENI 1

LËNDA E MARRËVESHJES

Sipas kësaj MSHe, FKEE ka rënë dakord t'i ofrojë Komunës shërbime të eficiencës së energjisë për përmirësimin e eficiencës së energjisë në objektin e saj, Pallati i kulturës "Asim Vokshi", rr. Nena Tereza,

1.1. Fusha e shërbimeve

FKEE ofron këto shërbime

1. Auditimi i Energjisë
2. Projektimi Teknik për implementimin e MEE
3. Zbatimi i MEE
4. Mbikëqyrja teknike e zbatimit të MEE
5. Komisionimi i projektit
6. Testi i performancës në komisionim për të konfirmuar kursimin e energjisë sipas Shtojcës 8
7. Prokurimi, menaxhimi i kontratës, menaxhimi financiar dhe raportimi i kërkuar për implementimin e MEE
8. Sigurimi i financimit për përgatitjen dhe zbatimin e MEE

Për zbatimin e shërbimeve që kërkojnë kapacitet profesional dhe licenca ose leje, FKEE angazhon kompani të kualifikuara. Për zbatimin e MEE-ve, Gjukurja SHPK & BRT (Emri i Kompanisë /

Kontraktori) është përzgjedhur nën tenderin për furnizimin e punëve të prokuruar nga FKEE, kontrata e së cilës është Shtojca 6 e kësaj MShE dhe është pjesë integrale e saj.

1.2 Cilësia e shërbimeve

FKEE ofron Shërbimet e saj drejtpërdrejtë ose përmes kontraktorëve të tij. FKEE merr përsipër përgjegjësinë e plotë për shërbimet e kryera përmes ekspertëve dhe kontraktorëve të saj. FKEE siguron Komunen për performancë të mirë të të gjitha punëve të kryera nën këtë MShE dhe funksionimin e duhur të MEE nga pranimi dhe komisionimi (duke përfshirë, instalimet, pjesët e tyre dhe pajisjet e instaluar) si dhe se punët dhe artikujt e tillë (a) janë të reja dhe me cilësi të mirë, (b) janë të pastra nga defektet në dizajn, material dhe punë; dhe (c) janë të përshtatshme për këtë qëllim.

1.3 Koordinimi i shërbimeve

FKEE do të koordinojë zbatimin e MEE me përfaqësuesin e autorizuar të Komunës (Elvane Qarkagjia) do të sigurojë koordinimin e punëve në objektin e tij. Për këtë qëllim, FKEE emëron Ardian Fazliu si menaxher projekti, përgjegjës për koordinimin e shërbimeve, si dhe Komuna emëron përfaqësuesin e tij të autorizuar sipas kësaj Marrëveshjeje.

1.4 Komisionimi dhe Pranimi i Shërbimeve

Shërbimet sipas kësaj MShE konsiderohen të përfunduara pas komisionimit të MEE, e cila konfirmohet nga nënshkrimi i të dy palëve në Certifikatën e Pranimi të Përkohshëm.

Pas komisionimit, një seri e plotë e dokumenteve në lidhje me nënprojektin, siç janë raporti i kontrollit të energjisë, skicat teknike, vizatimet "siç janë ndërtuar", raporti i matjes dhe verifikimit, të gjitha certifikatat dhe manualët e produkteve të MEE, etj, do t'i sigurohen Komunës.

1.5 Financimi dhe Kompensimi

FKEE është e angazhuar të financojë MEE dhe aktivitetet për përgatitjen dhe zbatimin e tyre sipas Ligjit të Kosovës Nr: 06 / L-079 për Eficiencën e Energjisë (LEE), nën komponentin kthyes, duke lejuar FKEE-në të investojë fondet e saj në një projekt të eficiencës së energjisë dhe rimarrë investimet e saj nga entiteti publik, bazuar në ripagesat nga kursimet e parashikuara të kostos së energjisë për një periudhë të dakorduar deri në 15 vjet. Për ndërtesat që veprojnë në temperatura të brendshme nën standardet¹, ose për ndërtesat që kalojnë nga ato pa reflektim të kostos (dru zjarri, qymyr, etj) ose lëndë shumë të ndotshme në mundësi më të qëndrueshme, përfituesi mund të bie dakord për ripagimet që tejkalojnë koston e parashikuar të energjisë së kursyer për një periudhë të dakorduar deri në 15 vjet, për të mbuluar koston e projektit të eficiencës së energjisë, e cila do të rezultojë në një përmirësim të temperaturës së brendshme dhe / ose azhurnim në opzione më të pastra ngrohjeje.

¹ Bazuar në EN 12831

FKEE synon të përdorë fondet e saj për financimin e MEE sipas Shtojcave 3, 4 dhe 5, si dhe shërbimet dhe aktivitetet përkatëse siç specifikohet në pikën 1.1. të Nenit 1. Komuna është e detyruar të kompensojë shpenzimet e MEE dhe shërbimeve të tjera në përputhje me dispozitat e kësaj MShE.

1.6 Pagesa e kompensimit

Komuna do të kompensojë për shërbimet e energjisë të ofruara nën këtë MShE 344,529.02 EUR (treqind e dyzet e katër mijë, pesëqind e njëzet e nëntë euro, zero dy centë), nga të cilat:

A. EUR 344,529.02 paguhet për MEE (përfshin shumën e paguar për auditimin e energjisë, modelin teknik, punimet, mbikëqyrjen teknike, trajtimin e mbetjeve të rrezikshme) (këtu e tutje "kostoja e investimit"). Kompensimi i koston së investimit paguhet nga Komuna në llogarinë bankare të FKEE me numër **170802060000153 në Bankën NLB**, në përputhje me Programin e Kompensimit të Investimit të dhënë në Shtojcën 7 të kësaj MShE.

B.a) Data e fillimit të detyrimeve të pagesës për kompensimin e investimit është dita e parë e muajit të parë pas përfundimit të tremujorit kalendarik, gjatë së cilës u nënshkrua Çertifikata e Pranimit të Përkohshëm. Pagesat do të bëhen jo më vonë se data 15 e muajit pasardhës kur është bërë detyrimi për pagesë. Nëse është e nevojshme, plani i pagesës do të rregullohet pas nënshkrimit të Çertifikatës së Pranimit të Përkohshëm për të pasqyruar i) shumën aktuale të investimit; ii) datën aktuale të përfundimit ose data e fillimit të pagesave.

b) Periudha e shlyerjes/pagesës dhe / ose shumat e kësteve mund të rregullohen me ndryshimet e mundshme në çmimet e energjisë me kusht që shuma e plotë t'i paguhet FKEE-së për një periudhë jo më të gjatë se pesëmbëdhjetë (15) vjet, siç përcaktohet në nenin 37 të Ligjit për Eficiencë të Energjisë.

c) Kompensimi i investimit konsiderohet i përfunduar me këstin e fundit të paguar nga Komuna.

d) Komuna mund të shlyejë plotësisht investimin në çdo kohë para përfundimit të Programit të Kompensimit të Investimeve pa iu nënshtruar ndonjë ndëshkimi.

e) Në rast të shkeljes së planit të pagesave, vonesat në pagesa (mos pagesa ose pagesa e vonuar), Komuna do t'i paguajë FKEE-së një gjobë në shumën prej 0,1% në vit të shumës së vonuar, por jo më shumë se 10% të shumës së pagueshme.

f) Nëse Komuna paguan detyrimin si një transfer të vetëm, atëherë FKEE fillimisht merr gjobën, pastaj koston e investimit.

g) Çdo tremujor, FKEE dhe Komuna bëjnë barazimin e pagesave. Sa i përket fundit të çdo viti kalendarik, palët nënshkruajnë aktin e pajtimit ku regjistrohen të gjitha detyrimet e pagesës (kostoja e investimit dhe gjoba).

1.7 Testi i performancës

FKEE do të aranzhojë një test të performancës në komisionimin e punëve për të konfirmuar kursimin e energjisë dhe periudhën e ripagimit të Komunës. Shtojca 8 përfshin një përshkrim të testit të performancës.

ENI 2

PROJEKTI KOMUNAL I EFICIENCES SË ENERGJISË PKEE

Proceset dhe procedurat për zbatimin e Projektit Komunal të Eficiencës së Energjisë (PKEE) janë paraqitur në Manualin e Operacioneve të FKEE, i cili është publikuar në faqen e saj të internetit. Një përshkrim i shkurtër i PKEE është dhënë në Shtojcën 2. Prokurimi në FKEE kryhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara në "Rregulloren e Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit IPF", datë korrik 2016, rishikuar në nëntor 2017 dhe gusht 2018. PKEE iu nënshtrua një kontrolli dhe vlerësimi të plotë mjedisor për zbulimin e rreziqeve të mundshme mjedisore, ndikimet operacionale dhe mundësitë e përgjithshme për pajtueshmëri me kornizën ligjore dhe rregullatorin mjedisor në fuqi në Republikën e Kosovës. Dokumenti i vlerësimit është në dispozicion në faqen e internetit të FKEE për referencë, dhe Lista e Kontrollit të Planit të Menaxhimit Mjedisor dhe Social të rënë dakord i cili do të ndiqet nga palët gjatë zbatimit të kësaj MShE.

2.1 MEE për Nënprojektet

Fushëveprimi i plotë i punës për MEE për nënprojektin është përmbledhur në Shtojcën 4 dhe 5 të kësaj MShE.

- a) Gjatë ekzekutimit të shërbimeve, FKEE mund të ndryshojë ose zëvendësojë ndonjë nga MEE ose të zbatojë MEE shtesë me marrëveshje me Komunën me kusht që:
 - (i) kushtet e vendpunimit të kërkojnë një rishikim të tillë;
 - (ii) operacione të tilla nuk do të ndryshojnë vlerën e kontratës, nivelin standard të konfortit dhe shërbimit dhe shpenzimet e investimit pa marrëveshje paraprake me shkrim/aneks kontratë me Komunën e ; dhe
 - (iii) ndryshimet e tilla janë të nevojshme për të përmbushur objektivin e parashikuar të Kursimeve të Energjisë (Kosto) në vendpunim.
- b) FKEE dhe Komuna do të vendosin së bashku në lidhje me rregullimet/aranzhimet që kanë të bëjnë me llogaritjen e : (i) kursimeve të parashikuara vjetore të energjisë, (ii) periudhën e thjeshtë të pagesës dhe (iii) rregullimin e planit të pagesës së investimeve, nëse është e nevojshme.
- c) Komuna nuk lejohet të ndryshojë, zëvendësojë, heqë dhe / ose rregullojë ndonjë MEE ose pjesë të tij pa miratimin paraprak me shkrim të FKEE, përveç në situata emergjente. Përveç detyrimeve, Komuna do të bëjë përpjekje për të përdorur vend punishten në mënyrën më të mirë dhe për të mirëmbajtur MEE në kushte të mira, sipas udhëzimeve të prodhuesve dhe të sigurojë funksionimin e duhur të pajisjeve të instaluar.
- d) Koha e zbatimit të MEE është e njëjtë me Programin e Ndërtimit dhe Instalimit si pjesë integrale e kontratës ndërmjet FKEE dhe Kontraktorit siç parashikohet në Shtojcën 6 të kësaj MShE. FKEE do të informoj Komunën për çdo rrezik të vonësës me shkrim brenda [15] (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike pas shkaktimit të vonësës. Në rast vazhdimi të vonësës së shaktuar, është i nevojshëm vetëm një njoftim.
- e) FKEE do të mbajë përgjegjësi për të gjitha humbjet ose dëmtimet, për pengesat ose vonesat gjatë zhvillimit të ndonjë pjese të punimeve të ndërtimit dhe gjithashtu të gjitha humbjet ose dëmet që vijnë nga natyra e punës që do të bëhet, nga moti i keq ose nga ndonjë rast i paparashikuar apo i papritur ose nga

rrethanat e krijuara në lidhje me punimet e ndërtimit, dhe asnjë kthim/pagese nuk do të bëhet nga Komuna për një humbje ose dëmtim të tillë.

Zgjatja e afatit është e lejuar për vonesat të cilat ndikojnë në Programin e Ndërtimit dhe Instalimit që rrjedhin nga shkaqe të paparashikueshme përtej kontrollit dhe pa fajin ose neglizhencën e FKEE-së. Ndryshimi i MShE kërkohet nëse ka ndodhur vonesa dhe nëse nevojitet zgjatje. Çdo zgjatje do të bëhet duke respektuar dispozitat e kontratës së punëve.

2.2 Përkufizimi i Përdorimit Bazë të Energjisë

Bazuar në rezultatet e auditimit të energjisë, niveli bazë i energjisë për nënprojektin është përcaktuar si konsumi mesatar aktual i energjisë dhe kostot e energjisë për një periudhë të tre viteve të mëparshme. Për më tepër, përcaktohet një bazë e llogaritur e konsumit të energjisë për parametrat tipikë të funksionimit, duke përfshirë:

- a) Zona e ngrohur
- b) Numri i ditëve të ngrohjes
- c) Orët e punës
- d) Temperatura e brendshme
- e) Temperatura e jashtme

Parametrat e nivelit bazë dhe komoditetit janë të dakorduara dhe janë dhënë në Shtojcën 4.

2.3 Kursimi vjetor i energjisë

Niveli i parashikuar i kursimeve vjetore të energjisë që rezultojnë nga MEE në këtë MShE është llogaritur dhe paraqitur në Shtojcën 4. Për planin e ripagimit, niveli i kursimeve bazohet në konsumin bazë të energjisë të përcaktuar si konsumi mesatar aktual i energjisë dhe kostot e energjisë për një periudhë të tre viteve të mëparshme. FKEE do të aranzhojë një test performance për të konfirmuar kursimet e energjisë. Ky proces është përshkruar në Shtojcën 8. Komuna do të bëjë përpjekje për të siguruar funksionimin e ndërtesës (ndriçimi, ngrohja, orët e funksionimit) në të njëjtat nivele me nivelin bazë të komoditetit për të përcaktuar kursimet e energjisë. Në rast se ndërtesa operonte në temperatura të brendshme nën standardet përpara MEE, Komuna mund ta operojë ndërtesën në temperatura të brendshme sipas standardeve pas përfundimit të MEE.

FKEE nuk mund të mbahet përgjegjës nëse kursimet e energjisë janë më të ulëta se sa pritej për arsye që janë jashtë kontrollit të tij, të tilla si ndryshimet në kushtet e funksionimit të objektit, rritja e temperaturës së brendshme përtej standardeve (p.sh. nivelet e komoditetit), rritjet ose uljet e çmimeve të energjisë, mot i pafavorshëm ose raste të tjera. Raste të tilla nuk mund të jenë bazë për ndonjë kërkesë të kualifikuar të Komunës për të përfunduar këtë MShE dhe / ose ndonjë pretendim tjetër ligjor. Sidoqoftë, në rast të kursimeve më të ulëta të energjisë, FKEE mund të ofrojë një zgjatje të periudhës së pagesës së kompensimit deri në 15 vjet në mënyrë që Komuna të vazhdojë të bëjë ripagimet nga kursimet e kostos së energjisë.

NENI 3

DETYRIMET E FKEE-së

FKEE do të sigurohet për zbatimin e Shërbimeve sipas kësaj MShE. FKEE është përgjegjëse për të gjitha Shërbimet e kryera nga stafi i tij, Kontraktorët e tij ose të tjerë të autorizuar nga FKEE.

3.1 Detyrimet e përgjithshme

- a) Prokurimi dhe mbikëqyrja e punëve të zbatuara nga Kontraktorët e FKEE, duke përfshirë kontrollimin e pajtueshmërisë së rezultateve të punëve të kryera me projektin dhe faturën e sasive, Kushtet e Referencës, rishikimin e raporteve të mbikëqyrësit të ndërtimit, sigurimin e heqjes së duhur të materialeve të rrezikshme, heqjen e mangësive të mallrave dhe punëve, nëse është e nevojshme, drejtimi i një kërkesë për përmbushjen e detyrueshme të detyrimeve;
- b) Monitorimi i zbatimit të PKEE, përfshirë përgatitjen dhe dorëzimin e raporteve mbi ekzekutimin e PKEE tek autoritetet dhe donatorët;
- c) Sipas nevojës, përgatitjen dhe ekzekutimin dhe / ose marrjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm teknik të kërkuar për marrjen e lejeve të kërkuara siq kerkohet dhe kryerjen e veprimtarive perkatese ne lidhje me to;
- e) Planifikimi dhe koordinimi i zbatimit të PKEE me Komuna në mënyrë që të minimizohet prishja e Programit të Ndërtimit dhe Zbatimit;
- f) Informimi i Komunës në mundësinë më të hershme për çështjeve që mund të ndikojnë materialisht në zbatimin e sigurt ose efikas të PKEE në objekt dhe ngjarje specifike të mundshme në të ardhmen ose rrethana që mund të ndikojnë negativisht në cilësinë e punimeve ose të vonojnë ekzekutimin e punimeve.
- g) Sigurimi i të gjitha garancioneve dhe certifikatat nga furnizuesit e materialeve dhe pajisjeve për Komunën dhe ofrimi i trajnimeve të përshtatshme për stafin e Komunes për funksionimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të instaluar në nënprojekt.

3.2 Standardi i Performancës

- a) Të kryejë shërbime me gjithë kujdesin e duhur ne menyre ekonomike dhe efikase, në përputhje me standardet dhe praktiket e pranuar profesionale të cilësisë, të vëzhgojë praktiket e menaxhimit të mirë dhe të përdorë teknologji të përshtatshme dhe pajisje, makineri, materiale dhe metoda të sigurta dhe efektive;
- b) Punësoj dhe siguroj staf të tillë të kualifikuar dhe me përvojë, siq kërkohe për të kryer Shërbimet e tij;
- c) Të mbaj të informuar Komunën në mënyrë transparente për statusin dhe progresin e shërbimeve.

NENI 4

DETYRIMET E KOMUNËS

Për të kryer dhe koordinuar këtë MShE, detyrimet e Komunës përfshijnë por nuk kufizohen në si vijon:

4.1 Të drejtat dhe detyrimet e përgjithshme

- a) Bashkëpunimi me FKEE dhe Kontraktorët e tij në të gjitha fazat e nën-projektit.
- b) Sigurimi i pagesave në kohë për FKEE bazuar në planin (seksioni 1.6).
- c) Të jap të gjithë informacionin e nevojshëm FKEE-së në të gjitha fazat e nënprojektit, i cili përfshin, por nuk kufizohet në:
 - (1) dokumentacioni teknik ekzistues në lidhje me objektin, si dhe informacionin për funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe pajisjeve;
 - (2) të dhënat, faturat në lidhje me përdorimin e energjisë së objektit, autorizimi i FKEE për të marrë një informacion të tillë nga furnizuesit e energjisë;
 - (3) çdo kërkesë e njohur e vendosur nga rregulloret dhe / ose kërkesat e ndërtimit (teknike), kufizimet që lidhen posaçërisht me objektin që ndryshojnë nga ato që zakonisht zbatohen për ndërtimin; dhe
 - (4) të gjitha informacionet dhe / ose dokumentet e tjera të kërkuara.
- d) Vënia në dispozicion e inxhinierëve, personelin mirëmbajtës dhe operativ të tij për intervista me FKEE, Kontraktorët e tij, si dhe donatorët dhe zyrtarët qeveritarë.
- e) Në rast se dëmtime të paparashikuara, të cilat nuk janë shkaktuar nga aktivitetet e FKEE, ndodhin në objekt gjatë periudhës kontraktuale të kësaj MShE, dhe rehabilitimi i tyre (riparimi ose zëvendësimi) është i nevojshëm për ekzekutimin e detyrimeve kontraktuale nga FKEE, Komuna është e detyruar të kryej të gjitha veprimet e kërkuara për rehabilitim, në periudhën më të shkurtër të arsyeshme kohore, dhe të mbajnë në përgjegjësi shpenzimet e atij rehabilitimi, për të cilën periudhë ekzekutimi i detyrimeve kontraktuale të FKEE nuk do të pezullohet.
- f) Kryerja e veprimtarive të nevojshme për marrjen e lejes së ndërtimit ose leje të tjera që lejojnë fillimin e zbatimit të nënprojektit dhe kryerjen e aktiviteteve të tjera të ndërlidhura;
- g) Merr pjesë në mënyrë aktive në aktivitetet e komisionit të FKEE;
- h) Certifikata në rast se FKEE ka dorëzuar shërbimet e dakorduara;
- i) Të informoj menjëherë FKEE sapo të ketë njohuri për çështje që mund të ndikojnë materialisht në detyrimet e FKEE ose Komuna sipas kësaj MShE ose të ndikojnë në funksionimin e sigurt ose efikas të PKEE;
- j) Të pranoj shqetesimet e arsyeshme dhe të përkohshme për zbatimin dhe komisionimin e punës, dhe lejimi / lehtësimi i performancës së Shërbimeve të FKEE-së, në përputhje me Programin e rënë dakord të Ndërtimit dhe Zbatimit;
- k) Të ndihmoj FKEE në krijimin e komiteteve të përdoruesve për të siguruar një mekanizëm kthyes gjatë përgatitjes, zbatimit dhe përfundimit të aktiviteteve të nënprojekteve;
- l) Të ndihmoj FKEE në sondazhet para dhe pas zbatimit për të vlerësuar kënaqësinë e përfutësve me zbatimin e nënprojekteve;
- m) Të parashikojë detyrimin e pagesës në përputhje me Planin e Kompensimit të Investimeve në buxhetin vjetor të Komunës për periudhën e MShE; dhe
- n) Përgjegjës për mbarëvajtjen dhe ekzekutim të duhur të punëve/operacioneve dhe Mirëmbajtjes nga momenti i komisionimit (Pranimi i Përkohshëm) dhe më tutje Periudhës së Garancisë.

4.2 Hyrja në vend-punimin e projektit

- a) Lejimi i dorëzimit të pajisjeve dhe materialeve në vend-punim.
- b) Siguron hapësirë të mjaftueshme dhe të përshtatshme pa qira, nëse është e disponueshme, për ruajtjen e materialeve në vend-punim. Ushtron kujdes të arsyeshëm dhe bashkëpunon me FKEE dhe Kontraktorët e tij në veprime që mund të jenë të nevojshme për të mbrojtur punën nga dëmtimi, vjedhja ose keqpërdorimi.

c) Siguron që FKEE, donatorët e tij dhe Kontraktorët të kenë qasje të pa penguar në vend punim ashtu siç mund të kërkohet nga FKEE, duke mos ndikuar negativisht në funksionimin e objektit, si dhe për prezantimin dhe shpërndarjen e rezultateve nga FKEE, që mund të përfshijë foto dhe video seanca.

4.3 Detyrë strikte për të zbuluar aktivitete konfliktuale

a) Të mos përfshihen, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në ndonjë aktivitet biznesi ose profesional që bie ndesh me aktivitetet e Komunës sipas kësaj MShE. Kjo gjithashtu përfshin rinovime ose ndryshime të ndara në ndërtesë.

Të paraqes çdo situatë të konfliktit aktual ose të mundshëm që ndikon në aftësinë e Komunës për t'i shërbyer interesit më të mirë të nën-projektit dhe ndaj FKEE dhe Kontraktorëve të tij, ose që mund të përceptohet në mënyrë të arsyeshme që mund të ketë efekt. Mos zbulimi i situatave të përmendura mund të çojë në pezullimin dhe / ose përfundimin e kësaj MShE.

NENI 5

NDËRPRERJA E MSHE

5.1 Përfundimi/Ndërprerja i/e Inicuar nga Komuna

Komuna mund të iniciojë përfundimin e MShE me të paktën 10 ditë njoftim paraprak ndaj FKEE. Marrëveshja konsiderohet e përfunduar nga data kur FKEE e pranon njoftimin. Në këtë rast, Komuna do të kompensojë të gjitha shpenzimet e FKEE të kryera sipas kësaj Marrëveshjeje deri në datën e njoftimit. Komuna do të kompensojë për punët dhe shërbimet e kryera, si dhe pajisjet dhe materialet e prokuruar. Ndërprerja me iniciativë të Komunës do të lirojë FKEE nga të gjitha detyrimet e tij pas datës së përfundimit/ndërprerjes së MSHE-së

5.2 Përfundimi/Ndërprerja i/e i Inicuar nga FKEE

Marrëveshja mund të përfundojë me iniciativë të FKEE në çdo moment, me kusht që FKEE të kompensojë të gjitha humbjet e Komunës, të ngritura si rezultat i Marrëveshjes. Të gjitha detyrimet e palëve ndalohen në datën e përfundimit/ndërprerjes, përveç detyrimeve të ngritura para datës së përfundimit.

5.3 Arsytet e Përfundimit/ndërprerjes

Arsyet e mëposhtme mund të sigurojnë baza për përfundimin e PKEE:

- a) Çështjet mjedisore të zbuluara gjatë zbatimit të PKEE duke rrezikuar mjedisin, p.sh. materiale që përmbajnë asbest ose ndonjë material tjetër i rrezikshëm;
- b) Vendimi i qeverisë për të mbyllur, zhvendosur, privatizuar, ose ndryshuar thelbësisht objektin e propozuar të Komunës ose për të ndryshuar natyrën e përdorimit të tij;
- c) Performanca jo e mirë e FKEE dhe / ose cilitdo prej kontraktuesve të tij;
- d) Shkelja e dispozitave të MShE nga Komuna.
- e) Mos zbatimi i MShE nga ndonjëra palë.

NENI 6

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

6.1 Barazia dhe Mirëbesimi

- a) Palët marrin përsipër të veprojnë me mirëbesim në lidhje me të drejtat e njëri-tjetrit sipas kësaj MShE dhe të miratojnë të gjitha masat e arsyeshme për të siguruar realizimin e objektivave të kësaj MShE.
- b) Të dy palët e kuptojnë plotësisht këtë marrëveshje dhe kushtet e përcaktuara në të, dhe e nënshkruajnë atë me vullnet të lire pa ndonjë detyrim ose kërcënim apo ndonjë formë tjetër që ka të bëjë me autorizim dhe miratime nëse është e nevojshme për nënshkrimin e kësaj MShE.

6.2 Ligji në fuqi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- a) Kjo MShE rregullohet nga ligjet e Republikës së Kosovës. Çdo mosmarrëveshje ose ndryshim që del nga kjo MShE zgjidhet nga gjykatat e juridiksionit kompetent të Republikës së Kosovës.
- b) Palët do të kërkojnë të zgjidhin çdo mosmarrëveshje miqësisht me konsultime të ndërsjella;
- c) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve që lindë ose lidhet me këtë MShE që nuk mund të zgjidhet në mënyrë miqësore mund të referohet nga secila palë në gjykim/arbitrazh në përputhje me juridiksionin e Republikës së Kosovës.
- d) Nëse njëra palë kundërshton ndonjë veprim ose mosveprim të palës tjetër, ajo mund të paraqesë një njoftim me shkrim të mosmarrëveshjes palës tjetër duke dhënë në detaje bazën e mosmarrëveshjes. Pala që merr njoftimin e mosmarrëveshjes do ta shqyrtojë atë dhe do të përgjigjet me shkrim brenda katërmëdhjetë ditëve pas marrjes. Nëse pala nuk arrin të përgjigjet brenda katërmëdhjetë ditëve, ose mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet miqësisht brenda katërmëdhjetë ditësh pas përgjigjes së asaj pale, dispozitat e kësaj MShE do të zbatohen.

6.3 Komunikimi ndërmjet palëve

- a) Të gjitha dokumentet që do të sigurohen ose komunikimet që do të jepen ose bëhen sipas kësaj MShE do të jenë në gjuhën Shqipe ose në atë Serbe (sido që dëshiron Komuna). Dokumentet që kërkojnë rishikim të Bankës Botërore shoqërohen me një përkthim në Anglisht.
- b) Çdo komunikim që kërkohet ose lejohet të jepet ose bëhet në përputhje me këtë MShE do të jetë me shkrim. Çdo njoftim, kërkesë ose pëlqim i tillë do të konsiderohet se është dhënë ose bërë kur i dorëzohet personalisht përfaqësuesit të autorizuar të Palës së cilës i drejtohet komunikimi, ose kur i dërgohet Palës në adresën e specifikuar në MShE ose në adresën e postës elektronike të Palës.

6.4 Konfidencialiteti

- a) Palët bien dakord të mos zbulojnë asnjë informacion në lidhje me kontratën, përveç rasteve të parashikuara nga kjo MShE dhe nga legjislacioni i Kosovës. Sipas MShE, të gjitha vizatimet, specifikimet, raportet, modelet, materialet elektronike dhe dokumente të tjera të ngjashme do të jenë pronë e Komunës. Të gjitha dokumentet e përmendura mund të përdoren nga FKEE dhe të publikohen vetëm për qëllime informuese të projektit.
- b) Përveç me pëlqimin paraprak me shkrim të Komuna, FKEE dhe / ose ndonjë nga Kontraktorët e tij 'nuk do të komunikojë në asnjë kohë me asnjë person ose entitet ndonjë informacion konfidencial të marrë gjatë rrjedhës së Shërbimeve, apo edhe FKEE dhe / ose Kontraktorët e tij nuk do t'i bëjnë publike rekomandimet e formuluar gjatë, ose si rezultat, i Shërbimeve;
- c) E njëjta gjë vlen për Komunën e cila në asnjë kohë nuk do t'i komunikojë asnjë personi ose subjekti asnjë informacion konfidencial të marrë gjatë Shërbimeve, poashtu Komuna nuk do t'i bëjë publike rekomandimet e formuluar gjatë, ose si rezultat i Shërbimeve.

6.5 Efektiviteti i ESA

- a) Kjo MShE do të hyjë në fuqi me datën e nënshkrimit nga përfaqësuesit e autorizuar të të dy palëve (në tekstin e mëtejme "Data Efektive").
- b) Kjo MShE është efektive deri në përfundimin e Kompensimit të Investimeve.

6.6 Forcë madhore

Termi forcë madhore, siç përdoret këtu mbulon çdo ngjarje të paparashikueshme, që nuk është brenda kontrollit të asnjërës palë në këtë MShE dhe të cilën duke ushtruar kujdesin e duhur asnjëra palë nuk është në gjendje të kapërcejë siç janë aktet madhore, grevat, bllokimet e tjera, shqetësime industriale, veprime të armikut publik, luftëra të shpallura ose të pa shpallura, kryengritje, trazira, epidemi, rrëshqitje dheu, tërmete, stuhi, rrufe, përmytje, shqetësime civile, shpërthim, pandemi. Pala nuk do të mbahet në shkelje të detyrimeve të saj kontraktuale nëse pengohet t'i përmbushë ato nga rrethana të forcës madhore. Në kontekstin e kësaj MShE, përfundimi i financimit nga Qeveria e Kosovës ose donatorët mund të konsiderohet si një ngjarje e forcës madhore.

Kjo MShE është nënshkruar në Prishtinë, në tre (3) kopje në shqip, tre (3) kopje në anglisht dhe / ose serbisht; një kopje do t'i jepet FKEE, një kopje Komunës, një kopje objektit (përfituesit). Kjo MShE mund të plotësohet dhe modifikohet vetëm me marrëveshje me shkrim të Palëve duke bërë një dokument të nënshkruar, kështu që çdo dokument i njëanshëm dhe përgjigjja ndaj kësaj të fundit nuk mund të konsiderohen si modifikim ose shtesë e kësaj MShE.

Për Komunën:

(vula dhe nënshkrimi i Kryetarit të Komunes së Gjakovës)

Për FKEE

(vula dhe nënshkrimi i Drejtorit Menaxhues)



SHTOJCA

Shtojcat e mëposhtme janë pjesë integrale e MShE e nënshkruar midis Komunës dhe FKEE:

Shtojca 1. Përkufizimet

Përveç nëse konteksti kërkon ndryshe, terminologjia e mëposhtme kurdo që përdoret në këtë MShE kanë kuptimet si në vazhdim:

- 1) "Masa për Eficiencën e Energjisë" nënkupton të gjitha masat teknike dhe jo-teknike të zbatuara gjatë gjithë ekzekutimit të PKEE në objektin në fjalë me qëllim përmirësimin e performancës së energjisë.
- 2) "Auditim i Energjisë" do të thotë vlerësimi i masave të mundshme të eficiencës së energjisë, përcaktimi i kushteve bazë të energjisë dhe vlerësimi i konsumit të energjisë dhe kursimeve të parashikuara të energjisë, dhe vlerësimi i qëndrueshmërisë së tyre financiare (periudha e thjeshtë e shpagimit).
- 3) "Punë" nënkupton punimet, duke përfshirë pajisjet dhe materialet, që do të kryhen nga kontraktori i FKEE-së në përputhje me Kontratën e nënshkruar për objektin në fjalë.
- 4) "PKEE" (Projekti Komunal i Eficiencës së Energjisë) "do të thotë projekti që do të ekzekutohet në objektin komunal për të arritur kursime të energjisë.
- 5) "Objekt" do të thotë ndërtesa publike komunale dhe / ose sistemi i ndriçimit rrugor në pronësi dhe administruar nga Komuna
- 6) "Komisionimi i projekteve" do të thotë vlerësimi i punëve të kryera në mënyrë që të sigurohet nëse një projekt është kryer sipas projektit detal dhe specifikacionit teknik në kontratë.
- 7) "Forcë madhore" do të thotë një ngjarje e cila është përtej kontrollit të arsyeshëm të një Pale në këtë MShE, nuk është e parashikueshme, është e pashmangshme dhe e bën punën e një Pale të detyrimeve të saj më poshtë të pamundur ose jopraktike që në mënyrë të arsyeshme të konsiderohet e pamundur nën rrethanat dhe duke iu nënshtruar këtyre kërkesave, përfshijnë, por nuk kufizohen në luftë, trazira, çrregullime civile, tërmet, zjarr, shpërthim, stuhi, përmytje ose kushte të tjera të pafavorshme të motit, greva, bllokime ose konfiskim të veprimeve të tjera industriale ose ndonjë veprim tjetër nga agjencitë qeveritare.

Shtojca 2. Projekti Komunal për Eficiencën e Energjisë

Burimet kryesore të energjisë për ngrohjen e hapësirës dhe ujit në ndërtesat në Kosovë janë biomasa e paqëndrueshme (kryesisht dru zjarri) dhe energjia elektrike (nga linjiti), së bashku përbëjnë mbi 80 përqind të konsumit të ngrohjes. Konsumi i lartë i druve të zjarrit të pamenaxhuar dhe parregulluar mund të çojë në degradim të pyjeve, duke sjellë ndikime të pafavorshme mjedisore, ekonomike dhe shëndetësore. Ngrohja me energji elektrike është shumë joefikase dhe përkeqëson ndërprerjet e furnizimit me energji ndërsa krijon nevojën për importe të energjisë elektrike, veçanërisht gjatë sezonit të ngrohjes (dimrit).

Masat e eficiencës së energjisë (EE) mund të ndihmojnë në adresimin e çështjeve që lidhen me sigurinë e energjisë (deficitet aktuale dhe importet e reduktuara), ndërsa zvogëlojnë shpenzimet publike për energjinë dhe ndikimet mjedisore të përdorimit të energjisë, duke përfshirë cilësinë lokale të ajrit, ngrohja e hapësirës është kontribuuesi kryesor.

Spektori i ndërtesave komunale përfaqëson rreth 1.6 milion metra katrorë (m²). Konsumi i përgjithshëm vjetor i energjisë së stokut të ndërtesës komunale është vlerësuar të jetë rreth 217,000 MWh, me një konsum mesatar specifik të energjisë prej 134 kWh / m² (gjithsej 18,68 ktoe), me një kosto totale të konsumit të energjisë në rreth 16 milion€. Llojet kryesore të ndërtesave në komuna janë zyrat, shkollat dhe spitalet.

Duke pasur parasysh që ndërtesat e komunave kanë përdorim shumë të lartë të energjisë dhe tejkalojnë normat për nivelet e brendshme të rehatisë, FKEE do të sigurojë mbështetje financiare për zbatimin e Masave të Eficiencës së Energjisë, të cilat do të rezultojnë në kursime të konsiderueshme të energjisë dhe kostos, si dhe për të përmirësuar nivelet e komoditetit dhe standardet e punës.

Të gjitha projektet e propozuara nga komunat do të aprovohen dhe financohen nga FKEE duke ndjekur kriteret e pranueshmërisë si më poshtë: Ndërtesat duhet të jenë në pronësi të Komunës (duke përjashtuar ndërmarrjet në pronësi publike ose komunale, ndërtesat private me qiramarrës të agjencive publike); Ndërtesat duhet të jenë të shëndosha nga ana strukturore, të mos kenë një rinovim të plotë të eficiencës së energjisë në 10 vitet e fundit dhe të jenë të vjetra të paktën 5 vjet; Ndërtesat nuk duhet të kenë ndonjë plan për lëvizje zyresh, mbyllje ose privatizim; Përfituesit duhet të jenë në gjendje të mirë financiare dhe të demonstrojnë disiplinë pagese; Ndriçimi i rrugës duhet të jetë një sistem ekzistues që është në pronësi, operohet dhe mirëmbahet nga qeveria komunale, dhe faturat e energjisë paguhet nga komuna; dhe Pasi aplikimi të kontrollohet dhe konfirmohet për të përmbushur kriteret e pranueshmërisë, komuna do të ftohet të nënshkruajë një Marrëveshje Inicimi të Projektit me FKEE.



Si bazë për secilin projekt të propozuar do të kryhen një auditim i detajuar i energjisë për të identifikuar masat e justifikuara ekonomikisht (dmth. Periudha e thjeshtë e shpagimit me rregullimin e nivelit të konfortit) me fokusin e mbështjellësit termik të ndërtesës (dritare, dyer, izolim muri / çati), sisteme ngrohje (kaldaja, tubacione dhe izolim, radiatorë, valvola / kontrolle, njehsorë), kalimi i karburantit (linjit / vaj në biomasë ose ngrohje qendrore kur është i vlefshëm), ftohje dhe ventilim, ndriçim dhe praktika të përmirësuara të funksionimit dhe mirëmbajtjes. Gjithashtu zëvendësimi ose azhurnimi i sistemit të ndriçimit rrugor si masa të eficiencës së energjisë që përmbushin kriteret e pranueshmërisë.

FKEE do të veprojë në emër të aplikantëve të përzgjedhur, do të planifikojë, do të prokurojë shërbime të jashtme të nevojshme sipas kërkesës dhe do të kontrakttojë/mbikëqyrë Furnizuesin e Punëve deri në përfundimin me sukses të projektit. Ndihma financiare do të sigurohet nga FKEE për mbulimin e kostove të investimit dhe një pjesë të kostove për punët përgatitore dhe tarifat në baza të kthyeshme.

Si funksionon një marrëveshje e shërbimit të energjisë nën mekanizmin e financimit të fondeve të kthyeshme:

FKEE do të aplikojë mekanizma inovativ financimi, siç janë marrëveshjet e shërbimit të energjisë (MShE), për të financuar nënprojektet e dakorduara për EE në ndërtesat komunale, me MShE që nuk klasifikohen si borxhe komunale. FKEE do të sigurojë një paketë shërbimi të plotë, duke përfshirë sigurimin e financimit, auditimin e energjisë, projektimin teknik, prokurimin dhe mbikëqyrjen e kontraktorit, mbrojtjet mjedisore dhe sociale, matjen dhe raportimin e kursimit të energjisë. Në këmbim, komuna do të pranojë të paguaj kursimet e kostos së energjisë të arritura për një periudhë të rënë dakord (deri në 15 vjet). FKEE do të ngarkoj tarifa të arsyeshme për të mbuluar financimin, shpenzimet operationale dhe përgatitjen e nënprojektit (p.sh. auditimet e energjisë, projektet teknike) që të jenë të qëndrueshme deri në fund të Projektit.

Shifrat më poshtë ilustrojnë idenë themelore të qarkullimit të parave të Komunës nën këtë MShE, me pagesa të barabarta me faturën e tyre fillestare të energjisë. Një skemë e tillë kërkon që agjencia të paguajë atë që po paguan sot pa marrë përsipër rreziqet e lidhura me investimet. Për ndërtesat që funksionojnë në temperatura të brendshme nën standardet, ose për ndërtesat që kalojnë nga jo-kosto reflektuese (dru zjarri, qymyr, etj.) dhe karburantet ndotëse të ngrohjes në opsione më të qëndrueshme, përfituesi mund të pranojë pagesa që tejkalojnë koston e parashikuar të energjisë së kursyer për një periudhë të rënë dakord deri në 15 vjet për të mbuluar koston e projektit EE, e cila do të rezultonte në një përmirësim të temperaturës së brendshme dhe/ose përmirësim të opsioneve më të pastra të ngrohjes.



Marrëveshja e Shërbimit të Energjisë (MSHE) e lidhur midis FKEE dhe aplikantit të përzgjedhur pas auditimit të energjisë, hartimit të projektit, të gjitha lejet janë në dispozicion dhe nënshkruhen para hyrjes në fuqi të kontratës për furnizimin e punimeve.

FKEE siguron cilësinë dhe saktësinë e shërbimeve dhe punëve të kryera nga cilido nga kontraktorët e tij. FKEE përveç dhënies së shërbimeve të jashtme të asistencës teknike do të sigurojë koordinimin e projekteve, menaxhimin, administrimin sipas praktikave më të mira ndërkombëtare dhe do të sigurojë raportim të rregullt tek IFI /donatorët që sigurojnë burime financiare për projektet e EE të Ndërtesave Komunale, bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Për më tepër, objektivat e projektit teknik dhe progresi i bërë në kuadër të projektit të propozuar do të monitorohet sipas këtyre treguesve të rezultateve:

- Kursimet e parashikuara të energjisë gjatë gjithë jetës nga investimet e EE në ndërtesa publike (GWh),
- Përdorimi i reduktuar i lëndëve djegëse fosile për ngrohje në ndërtesat publike (toe), dhe
- Emetimet GHG.

Shtojca 3. Emrat dhe kostot e kontraktorëve për auditimin e energjisë, projektimin teknik, punimet, mbikëqyrjen teknike dhe vënien në punë.

Nr	Kontrata/Fushëveprimi	Kontraktori	Shuma	Nr i kontratës (opcionale)
1.	Auditimi i Energjisë, modelet teknike, mbikëqyrja dhe komisionimi dhe periudha e DLP	Links Studio 4	11,659.52 Euro	KEEF/1C21/CQ/2020 LOT 1
2.	Punët për zbatimin e MEE	Gjukurja SHPK & BRT	332,869.50 Euro	
	Totali për objektin		344,529.02 Euro	

Shtojca 4. Përmbledhje e informacionit teknik, konsumi bazë i energjisë dhe masat e efijencës së energjisë (MEE) të zbatuara sipas kësaj MShE.

- Titulli i institucionit
- Informacioni i kontaktit
- Karakteristikat kryesore teknike (përshkrim i shkurtër i ndërtesave, mureve, çatisë, papafingo, ngrohje, ftohje, ndriçim, ujë të nxehtë)
- Parametrat kryesor operacionalqë nxisin konsumin e energjisë (zona, numri i përfituesve, orët e funksionimit, ditët, ditët boshe)
- Konsumi bazë i energjisë (vjetore dhe mujore)• Parametrat bazë (temperatura mesatare e jashtme gjatë sezonit të ngrohjes, temperatura mesatare e brendshme gjatë sezonit të ngrohjes)
- Vështrim i përgjithshëm i MEE-ve të zbatuar në kuadër të këtij MShE (zëvendësimi i dritareve, zëvendësimi i sistemit të ngrohjes, izolimi i mureve, etj)
- Potenciali i kursimit të energjisë (%)
- Kursime vjetore të energjisë (energji elektrike, gaz, lëndë djegëse të tjera)
- Kursimet vjetore të kostos së energjisë (Euro)
- Investimet e vlerësuara (Euro)
- Shpagimi i thjeshtë
- NPV

Shtojca 5. Detajet mbi Masat e Efiçencës së Energjisë (MEE)

Tabela e BOQ e kontraktuar duke përfshirë shumat në EUR (përfshihet pas nënshkrimit të kontratës per secilin nën projekt)

Shtojca 6. Kontrata midis FKEE dhe Kontraktorit për Punimet

[Kontrata e ndërtimit pa BoQ] (përfshihet pas nënshkrimit të kontratës për secilin nën projekt)

Shtojca 7. Plani i Pagesave

Plani i Pagesave për MEEP me kosto investimi prej 344,529.02 EUR (për auditimet e energjisë, projektimin, punimet, mbikëqyrjen, komisionimin dhe testimin e performancës), për periudhën e pagesës prej 15 vite. Këstet e pagesave të ndara në periudha tremujore.

Data	Shuma për pagesë	Afati i pagesës
01.01.2023	5,742.15 €	15.04.2023
01.04.2023	5,742.15 €	15.07.2023
01.07.2023	5,742.15 €	15.11.2023
01.10.2023	5,742.15 €	15.01.2024
01.01.2024	5,742.15 €	15.04.2024
01.04.2024	5,742.15 €	15.07.2024
01.07.2024	5,742.15 €	15.11.2024
01.10.2024	5,742.15 €	15.01.2025
01.01.2025	5,742.15 €	15.04.2025
01.04.2025	5,742.15 €	15.07.2025
01.07.2025	5,742.15 €	15.11.2025
01.10.2025	5,742.15 €	15.01.2026
01.01.2026	5,742.15 €	15.04.2026
01.04.2026	5,742.15 €	15.07.2026
01.07.2026	5,742.15 €	15.11.2026
01.10.2026	5,742.15 €	15.01.2027
01.01.2027	5,742.15 €	15.04.2027
01.04.2027	5,742.15 €	15.07.2027
01.07.2027	5,742.15 €	15.11.2027
01.10.2027	5,742.15 €	15.01.2028
01.01.2028	5,742.15 €	15.04.2028
01.04.2028	5,742.15 €	15.07.2028
01.07.2028	5,742.15 €	15.11.2028
01.10.2028	5,742.15 €	15.01.2029
01.01.2029	5,742.15 €	15.04.2029
01.04.2029	5,742.15 €	15.07.2029
01.07.2029	5,742.15 €	15.11.2029
01.10.2029	5,742.15 €	15.01.2030
01.01.2030	5,742.15 €	15.04.2030
01.04.2030	5,742.15 €	15.07.2030
01.07.2030	5,742.15 €	15.11.2030
01.10.2030	5,742.15 €	15.01.2031
01.01.2031	5,742.15 €	15.04.2031
01.04.2031	5,742.15 €	15.07.2031
01.07.2031	5,742.15 €	15.11.2031
01.10.2031	5,742.15 €	15.01.2032

01.01.2032	5,742.15 €	15.04.2032
01.04.2032	5,742.15 €	15.07.2032
01.07.2032	5,742.15 €	15.11.2032
01.10.2032	5,742.15 €	15.01.2033
01.01.2033	5,742.15 €	15.04.2033
01.04.2033	5,742.15 €	15.07.2033
01.07.2033	5,742.15 €	15.11.2033
01.10.2033	5,742.15 €	15.01.2034
01.01.2034	5,742.15 €	15.04.2034
01.04.2034	5,742.15 €	15.07.2034
01.07.2034	5,742.15 €	15.11.2034
01.10.2034	5,742.15 €	15.01.2035
01.01.2035	5,742.15 €	15.04.2035
01.04.2035	5,742.15 €	15.07.2035
01.07.2035	5,742.15 €	15.11.2035
01.10.2035	5,742.15 €	15.01.2036
01.01.2036	5,742.15 €	15.04.2036
01.04.2036	5,742.15 €	15.07.2036
01.07.2036	5,742.15 €	15.11.2036
01.10.2036	5,742.15 €	15.01.2037
01.01.2037	5,742.15 €	15.04.2037
01.04.2037	5,742.15 €	15.07.2037
01.07.2037	5,742.15 €	15.11.2037
01.10.2037	5,742.15 €	15.01.2038

TOTALI	344,529.02 €
--------	---------------------

Spjegim i pagesës sipas planit të percaktuar për pagesa;

1 (një) vit përmban 4 periudha (tremujore), ndërsa periudha e shlyerjes është 15 vite atëhere $15 \times 4 = 60$ periudha për pagesë.

$344,529.02 / 60 = 5,742.15$ shuma për një tremujor.

Shtojca 8. Testi i performancës

Objektivi i testit të performancës është të konfirmojë kursimet e vlerësuara të energjisë në fazën e komisionimit.

Për pranimin e punimeve, është e nevojshme të verifikohet që Projekti i eficiencës së energjisë është përfunduar në një mënyrë për të kursyer energji për përfituesin me testimin e komisionimit dhe performancës. Përfituesi do të informohet për të gjitha procedurat e komisionimit dhe duhet të jetë i pranishëm në vend gjatë këtyre procedurave. FKEE do të organizojë një test të performancës për secilën masë të eficiencës së energjisë (MEE). FKEE informon përfituesin me një njoftim me shkrim të paktën 10 (dhjetë) ditë para testeve të planifikuara. Përfituesi mund të caktojë një përfaqësues për të marrë pjesë në ndonjë ose në të gjitha këto teste të kryera.

